

Të dashur prindër,

Epidemia e bronkiolitit fillon zakonisht në vjeshtë dhe përfundon në fund të dimrit dhe shpesh shkaktohet nga virusi respirator sincicial (VRS). Është një infeksion respirator potencialisht i rëndë që shkakton inflamacion të bronkeve të vogla dhe prek fëmijët nën 12 muaj - foshnjat nën tre muaj kanë një rrezik më të lartë komplikimesh dhe shtrimesh në spital.

Simptomat e bronkiolitit janë si vijon:

- kollë
- ethe
- hundë e bllokuar
- vështirësi në frymëmarrje

Nëse foshnja juaj ka këto simptoma, konsultohuni shpejt me pediatrin e tij. Në rast shenjash rëndimi si ndryshim në sjellje, foshnjë më pak reaktive, që ha më pak, merr frymë shumë shpejt ose shumë ngadalë ose në mënyrë të çrregullt, ose nëse buzët ose majat e gjymtyrëve të tij bëhen blu, çojeni atë direkt në urgjencë.

Rekomandohen masa të thjeshta parandaluese:

- Para moshës 3 muaj, kufizoni vizitat në rrethin e të rriturve të afërt dhe jo të sëmurë
- Lani duart (ose përdorni një solucion hidroalkoolik) para dhe pas prekjes së foshnjës
- Vendosni vetë një maskë në rast rrufe, kolle ose ethesh
- Nëse pjesa tjetër e vëllezërve dhe motrave paraqet simptoma infeksioni viral, mbajeni atë sa më larg foshnjës gjatë fazës akute të infeksionit
- Shmangni nëse është e mundur mbledhjet familjare dhe frekuentimin e vendeve publike

Sot, një trajtim parandalues është i disponueshëm: Beyfortus®. Ky ilaç me bazë antitropash (imunizim) zvogëlon rrezikun e infeksionit me VRS tek fëmijët, në plotësim të masave parandaluese. Merretme një dozë të vetme me injeksion intramuskular.

Marrja e Beyfortus® rekomandohet tek të gjithë të porsalindurit dhe foshnjat nën një vjeç. Kosto e Beyfortus® dhe e injektimit të tij mbulohet nga sigurimet shëndetësore me përjashtim të kuotës prej 10%.

Beyfortus® duhet të merret idealisht:

- Gjatë muajit tetor për fëmijët e lindur ndërmjet prillit dhe shtatorit 2024.
- Në ditët e para të jetës për fëmijët e lindur ndërmjet tetorit 2024 dhe fundit të marsit 2025

Si çdo ilaç, Beyfortus® mund të shkaktojë efekte të pa dëshirueshëm. Megjithëse të rrallë, efektet e pa dëshirueshëm të mundshëm janë:

- çarje e lëkurës
- reaksion në vendin e injektimit (skuqje, ënjtje dhe dhimbje)
- ethe
- në raste shumë të rrallë, një reaksion alergjik

Këto efekte të pa dëshirueshëm mund të shfaqen deri në disa ditë pas injektimit. Në përgjithësi janë me intensitet të lehtë ose të moderuar dhe me kohëzgjatje të shkurtër.

Shërbimi i mjekut kantonal, Spitalet Universitare të Gjenevës dhe Shoqata e Pediatriisë së Gjenevës e rekomandojnë fuqimisht këtë trajtim për fëmijët tuaj.

Për më shumë informacion, luteni të vizitoni faqen e internetit të dedikuar të shërbimit të mjekut kantonal <https://www.ge.ch/c/rsv>



Modalitetet për të marrë trajtimin mund t'ju shpjegohen gjatë qëndrimit tuaj në maternitetet e kantonit ose nga pediatri i fëmijës tuaj.

Dr Simon Regard,
mjek kantonal zëvendësues

Arnaud L'Huillier
mjek përgjegjës njësie, Njësi e sëmundjeve infektive pediatrike, HUG

Dr Jean-Yves Corajod, Shoqatë e
Pediatriisë së Gjenevës